

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI “FICO”

Banesa “Fico” ndodhur në lagjen “Varosh” në Gjirokastër është Monument Kulture i Kategorisë së I. Në vitin 2015 në këtë objekt ndodhi një shembje e gjysmës së murit të pasëm të shtëpisë, në fasadën Perendimore.

Nga masat e mara objekti është i pajantuar si nga brënda ashtu edhe nga jashtë me trarë druri trashësie 12 dhe 16 cm. Në projekt është parashikuar prishja e gjithë murit të dëmtuar dhe ndërtimi i një tjetri ne vend të tij.

1. Pajantimi

Pajantimi i objektit do të përforcohet te ai ekzistues. Duke filluar nga katër përdhe do të duplohen të gjitha kollonat e drurit, do të shkulen me kujdes, dhe do të zëvendësohen të gjitha kollonat dhe trarët e dëmtuar nëse ka. Pajantimi do të bëhet me trarë druri trashësie 14 dhe 16 cm lënde pishe ose bredhi pa kosto të medha. Pasi të bëhet pajantimi dhe të bëhet miratimi i supervizorit do të fillojë cmontimi i catise së objektit.

2. Cmontimi e catisë

Për të lehtesuar peshën që do të marri pajantimi do të fillojë të lehtësohet muri me heqjen e një pjese të catisë. Catia e dëmtuar do të hiqet si dhe catia e pjesës qëndrore, e cila është në kushte të vështira dhe luan rol në qëndrueshmërinë e objektit. Rasa e gurit do të hiqet dhe do të depozitohet poshtë objektit.

3. Pastrime dhe gërmime

Pasi të hiqet rasa e gurit do të bëhet pastrami i murit nga vegjetacioni dhe pastrami i të gjithë pjesës së pasme të banesës nga balta dhe nga gurët e rënë. Guret e nxjerrë vendosen poshtë objektit per t'u perdonur, kurse mbeturinat largohen jashtë objektit.

4. Cmontimi i murit të gurit

Pjesa e murit të dëmtuar, pasi të ndërtohet skela, fillon dhe cmonohet. Cmontimi bëhet me kujdes duke mos përdorur forcë për shkëputjen e gurëve. Atje ku ka ngelur brezi i drurit, zbërthehet me kujdes dhe merren masa për të vendosur brez të ri me përmasa ristelash 5x7 cm. Prishja do të bëhet pjesë – pjesë duke arritur deri në pjesën e padëmtuar, te themellet. Supervizori do të vendosi deri në cfarë thellësie do të arrijë prishja e murit për arsy se nga brënda banesës nuk është e dukshme, pasi objekti është i mbuluar me dhe.

5. Restaurimi i murit të gurit në themel dhe xokol



Sipas gjëndjes së objektit, pasi të bëhet pastrimi dhe të shihet në thellësi do të bëhet restaurimi i xokolit dhe themelit sipas gjëndjes. Muri i gurit do të bëhet me llac të përzier duke i shtuar llacit gëlqere edhe cimento për ta lidhur më mirë me këtë pjesë të murit pasi do të jetë në thellësi dhe nga pas nuk do të duket. Duhet pasur kujdes te vendosja e brezave të drurit sipas projektit. Bashkimi me brezin e vjetër do të behet me kujdes duke gjetur pjesë të forta të pa kalbura. Brezat gjatësore do të zëvendësohen cdo 80 cm me përmasa 5x7 cm dhe do të lidhen cdo 50 cm me po të njëjtën ristelë.

6. Ndërtim mur guri në lartësi

Ndërtimi i murit do të miret në lartësi sipas projektit me prerjet në gjerësi të tij. Do të hiqen me kujdes brezat, do të vendosen sipas projektit cdo 80 cm lartësi. Ristelat do të janë lëndë lis i stazhionuar. Muri do të ndërtohet me gurët që do të janë gjëndje dhe do vendoset edhe guri ri sipas nevojave. Laci do të jetë qëlqere në reportin 2 me 1. Do të bëhet kujdes për lidhjen e trarëve të objektit me brezin e drurit duke përdorur gozhdë të mëdha.

7. Restaurimi i strehës së catise pa dekor dhe cati rasë guri

Streha e catisë së dëmtuar në një pjesë të madhe, në anën e pasme do të bëhet restaurim duke përdorur bishta pishe të stazhionuar. Streha është e ngushtë dhe nuk është e dekoruar. Do të seleksionohen të gjitha elementët e dëmtuara dhe do të vendosen të reja.

Edhe catia me rase guri që ishte e dëmtuar dhe e hoqëm për arsyet e peshës do të restaurohet duke ndërruar cdo element të catisë së dëmtuar. Nuk do të ketë ngritje apo ulje kuote, Ajo do të jete fikse me ate ekzistuesen. Pjesët e catisë që do të zëvendësohen dhe petavrave do të janë lëndë pishe e stazhionuar. Pasi të ndërtohet muri dhe catia, hiqet me kujdes pajantimi duke filluar nga lartë poshtë. Pastaj bëhet meremetimi i dyshemeve dhe suvatimeve. Suvatimi bëhet si ishte me materiale ku do të përdoret edhe llac gëlqere.

Vasil
Polo
Digitally signed by
Vasil Polo
Date: 2023.04.19
10:14:35 +02'00'

Konceptoi:

Ing Vasil Polo

